REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 02.03.2015 vit.god. | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 01- | 013/246 | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 12,2 pika d, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 ( Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosvës nr. 28/2008), si dhe nenit 36.2 pika d, të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2015., aprovon këtë:

# RR E G U LL O R E
# PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË VITISË

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, lartësia e bursës dhe procedura për ndarjen e bursave për studentë/e të Komunës së Vitisë, të cilët studiojnë në universitete publike të Republikës së Kosovës.

### Neni 2

Komuna e Vitisë, varësisht nga mjetet financiare që ka në dispozicion, ndan bursa për studentë/e të komunës së Vitisë.

### Neni 3

3.1 Të gjithë studentët/et e rregullt, që janë banorë të Komunës së Vitisë, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të universiteteve publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoratë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave të studimeve.
3.2 Përparësi në fitimin e së drejtës në bursë do të kenë studentët/et që studiojnë në lëmenjtë deficitarë.

## Neni 4

Kryetari i Komunës merr vendim për numrin e bursave, që do të ndahen sipas fushave të studimeve, si dhe shumën financiare për një bursë, e që ndahet për një vit akademik.

## Neni 5

5.1. Bursat për studentë/e do të ndahen nga Komisioni, i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.
5.2 Komisioni do të jetë i përbërë nga 5 anëtarë.

## Neni 6

6.1 Drejtoria e Arsimit do të shpallë konkursin për ndarjen e bursave. Konkursi duhet të jetë i shpallur në mjetet e informimit, përkatësisht në dy gazeta ditore, në Ëeb-faqen e Komunës, në tabelën e shpalljeve, dhe do të qëndrojë i shpallur për 15 ditë.
6.2 Në konkurs do të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat tjera të nevojshme.

## Neni 7

Drejtoria e Arsimit obligohet që t'i kryejë punët e domosdoshme tekniko-administrative që rrjedhin nga natyra e punës së Komisionit, si dhe punët rreth shpalljes së konkursit, pranimit të kërkesave si dhe formulimit të kontratave e të ngjashme.

# II. KUSHTET DHE KRITERET

## Neni 8

8.1 Për realizimin e së drejtës në bursë, kandidatët /et duhet t`i plotësojnë kushte si në vijim:
a) të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa
b) të mos jenë shfrytëzues/e të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar
c) kandidatët/et që janë regjistruar për herë të parë në fakultete, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme dhe diplomën paraprake
d) të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomiko-sociale të familjes.

8.2 Gjendja ekonomiko–financiare e familjes së kandidatit/es vërtetohet në bazë të dëshmive të lëshuara nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Shërbime Sociale ( DSHSHS ) - Qendra për Punë Sociale. Komisioni ruan të drejtën të hulumtojë dhe vërtetojë gjendjen reale ekonomiko - financiare të kandidatit/es.

## III. KRITERET DHE PËRPARËSITË

### Neni 9

Për suksesin e arritur në mësime në vitin paraprak, kandidati/ja vlerësohet me pikë si në vijim:
a) studenti/ja me notë mesatare mbi 9 (nëntë), vlerësohet me 30 pikë
b) studenti/ja me notë mesatare mbi 8 (tetë), vlerësohet me 20 pikë
c) studenti/ja me notë mesatare mbi 7 (shtatë), vlerësohet me 15 pikë
d) studenti/ja në asistencë sociale, vlerësohen me 20 pikë
e) studenti/ja me studime në lëmenjtë deficitarë, vlerësohet me 15 pikë
f) studenti/ja që studiojnë së bashku me një anëtar/e nga e njëjta familje vlerësohet 10 pikë
g) studenti/ja, i cili nuk i ka prindërit në jetë, vlerësohen me 10 pikë
h) studenti/ja me aftësi të kufizuar vlerësohet me 10 pikë
i) studentët e vitit të I-rë që kanë arritur sukses të shkëlqyeshëm në të gjitha vitet e shkollimit të mesëm vlerësohen me 10 pikë

### Neni 10

Në kushtet dhe kriteret e njëjta të cekura në nenin 9, do të kenë përparësi studentët e familjeve të dëshmorëve, të viktimave civile të luftës, të veteranëve, të invalidëve të luftës, dhe studentët të gjinisë femërore

## IV. VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE

### Neni 11

Pas skadimit të afatit të konkurrimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e kërkesave. Gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave, komisioni do të përcaktojë metodën e punës dhe mënyrën e seleksionimit të kërkesave, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

### Neni 12

12.1 Pas përfundimit të procedurës së seleksionimit, komisioni do të hartojë listën përgjithshme të kandidatëve/eve përfitues/e të bursës.
12.2 Lista e përfituesve do të shpallet publikisht dhe do të vendoset në tabelën e shpalljeve të Drejtorisë së Arsimit.

### Neni 13

13.1 Kundër vendimit për shpalljen e listës së përfituesve të bursave nga Komisioni për ndarjen e bursave, lejohet ankesa, e cila i drejtohet Komisionit të ankesave, i formuar "ad hoc" me vendim të Kryetarit të Komunës. Ankesa ushtrohet në afat prej 7 ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga ana e komisionit.
13.2 Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesën e ushtruar.

**Neni 14**

14.1 Me përfituesit/et e bursave do të lidhet kontrata, e cila do të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi/ja i bursës.
14.2 Nëse nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit/es brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e njoftimit të kandidatit/es përfitues/e të bursës, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa dhe përfitues do të jetë kandidati që është në listë sipas radhës.
14.3 Kohëzgjatja për dhënien e bursës, obligimet e përfituesit/es të bursës dhe kushtet tjera, do të përcaktohen me kontratë.

## V. PROCEDURA E PAGESËS

**Neni 15**

15.1 Mjetet financiare do të alokohen me 1 (një) ose 2 (dy) periudha të caktuara gjatë vitit fiskal në xhirollogaritë bankare të përfituesve, në bankën të cilën studenti/ja e ka përzgjedhur.
15.2 Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Arsim, janë të obliguara të kujdesen për alokimin dhe zotimin e mjeteve të cekura më lart, në afatin kohor.

## VI. DISPOZIATA PËRFUNDIMTARE

**Neni 16**

Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

**Neni 17**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

**Viti, Shkurt 2015**

**Naim PIRA**

Kryesues i Kuvendit të Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 02.03.2015
Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost
01-013/246

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Viti
Skupstina Opstine Vitina
Municipal Assambly Viti

# SKUPSTINA OPSTINE VITINA

# PRAVILNIKA
# O DODELI STIPENDIJE ZA STUDENTE OPSTINE VITINA

VITINA, FEBRUARA – 2015

Na osnovu clana 12.2, tacke (d) Zakona o Lokalnoj Samoupravi („Sluzbeni list Republike Kosova“ br.28/2008) kao i po clan 36.2, tacke (l) Statuta Opstine Vitina 01.br.013/491 od datuma 21.04.2011, Skupstina Opstine Vitina, na odrzanoj sednici dana 27.02.2015.godine, usvaja ovaj:

# PRAVILNIK
# O DODELI STIPENDIJA ZA STUDENTE OPSTINE VITINA

## I. OPSTE ODREDBE

### Clan 1.

Sa ovim pravilnikom odredjuju se uslovi, kriteri, trajanje stipendijske realizacije, visina stipendije i procedure o dodeli stipendije za studente Opstine Vitina, koji studiraju pri Javnom Unervizitetu Republike Kosova.

### Clan 2.

Opstina Vitina, uz zavisnost finansijskih sredstava koje ima na raspolaganje, dodeljuje stipendije studentima Opstine Vitina.

### Clan 3.

**3.1.** Svi redovni studenti, koji su stanovnici Opstine Vitina, bez ikakve razlike etnickog, polnog, rase, verskog i politickog, koji su upisani pri fakultetu Javnog Unerviziteta – iskljucujuci studente postdiplomskih studija master i doktorature, imaju prava konkurisati za dodelu stipendije za studiranje.

**3.2.** Prednost na dobijanju prava na stipendiji imace studenti koji studiraju deficitarnu oblast (domen).

### Clan 4.

Predsednik Opstine donosi odluku o broju stipendista, koji ce se dodeliti po studentskim oblastima, kao i finansijski iznos za jednu stipendiju, a koja se dodeljuje za jednugodisnju akademsku godinu.

### Clan 5.

**5.1.** Stipendije za studente dodelice se od strane Komisije, formiranog sa odlukom Predsednika Opstine.

**5.2.** Komisija bice u sastavu od 5 (pet) clanova.

**Clan 6.**

**6.1.** Uprava Obrazovanja objavice konkurs o dodeli stipendije. Konkurs treba biti objavljen u informativnim sredstvima, odnosno u dve dnevne novine, Web-stranici Opstine, u tabeli objavljivanja, i stajace objavljen za 15 dana.

**6.2.** U konkursu bice odredjena trazena dokumentacija kao i ostale potrebne informacije.

**Clan 7.**

Uprava za obrazovanje obavezuje se izvrsavati neophodne radove odnosno zadatke tehnicke – administrativne koje proizilaze od prirode rada Komisije, kao i radovi oko objavljivanja konkursa, prijema zahteva kao i formuliranje ugovora, i slicno.

## II. USLOVI I KRITERI

**Clan 8.**

**8.1.** Za realizaciju prava na stipendiji, kandidati trebaju ispunjavati uslove, kao sto sledi:

**a)** da imaju upisani akademsku godinu za kojeg se da stipendija,
**b)** da nije korisnik/ca neke druge stipendije ili da su zaposljeni,
**c)** kandidati koji su registrovani po prvi put u fakultetu, trebaju imati dokaze uspeha od srednje skole kao i prethodnu diplomu., i
**d)** da predstave dokaze o porodicnom ekonomskom-socijalnom stanju.

**8.2.** Stanje ekonomsko-finansijski porodice kandidata potvrdjuje se na osnovu izdatog dokaza od Uprave za Zdravstvo i Socijalnih Usluga (UZSU) – Centar za Socijalni Rad. Komisija cuva pravo istrazivanja i potvrdjuje realno stanje kandidata o ekonomskom – finansijskom stanju.

## III. KRITERI I PREDNOSTI

**Clan 9.**

Za postignuti uspeh na ucenju sa prethodne godine, kandidat ocenjuje se sa poenima, kao sto sledi:

a) Student sa prosecnom ocenom iznad 9 (devet), ocenjuje se sa 30 tacke (poena),
b) Student sa prosecnom ocenom iznad 8 (osam), ocenjuje se sa 20 tacke (poena),
c) Student sa prosecnom ocenom iznad 7 (sedam), ocenjuje se sa 15 tacke (poena),
d) Student pod socijalnom asistencijom , ocenjuje se sa 20 tacaka (poena),
e) Student koji studira deficitarnu oblast, ocenjuje se sa 15 tacaka (poena),
f) Student koji zajedno studira sa jednim clanom/ od iste porodice procenjuje se sa 10 tacaka (poena),
g) Student koji nema roditelje u zivotu, ocenjuje se sa 10 tacaka (poena),
h) Student sa ogranicenim sposobnostima ocenjuje se sa 10 tacaka (poena), i
i) Studenti p – I- (prve Godine koji su postigli odlican uspeh po svim godisnjim skolovanju odnosno u srednjoj ocenjuje se sa 10 tacaka (poena).

**Clan 10.**

Pod istim uslovima i kriterima odredjenim sa clanom 9, imace prednosti studenti porodice heroja, zrtvama civilnog rata, veterana, ratnih invalida i studenti zenskog pola.

## IV. PROCENJIVANJE USLOVA I KRITERA

**Clan 11.**

Po isteku roka konkurisanja, komisija vrsice procenu zahteva. Tokom procedure procenjivanja zahteva, komisija odredice metodu rada i nacin selekcionisanja zahteva, uvek bazirajuci se pod odredjenim uslovima i kriterima u ovom pravilniku.

**Clan 12.**

12.1. Po zavrsetku procedure selekcionisanja, komisija pripremice opstu/i listu (spisak) kandidata dobitnika stipendije.
12.2. Spisak dobitnika objavice se javno i postaviti na javnoj tabeli Uprave za Obrazovanje.

**Clan 13.**

13.1. Protiv odluke objavljenog spiska (liste) dobitnika stipendije od strane Komisije za dodelu stipendije, dozvoljava se zalba, koja se upucuje Komisiji za zalbe, formiranom „ad hoc“ sa odlukom Predsednika Opstine. Zalba

podnosi se u roku od 7 (sedam) dana od dana objavljivanja liste dobitnika stipendije od strane Komisije.

**13.2.** Komisija za razmatranje zalbi, u roku od 15(petnaest) dana treba odluciti u vezi podnete zalbe.

**Clan 14.**

**14.1.** Sa dobitnicima stipendije donece se ugovor, koja ce se potpisivato od Predsednika Opstine i dobitnika stipendije.

**14.2.** Ako se ne potpisuje ugovor od strane studenta u roku od 30 (trideset) dana od dana obavestenja kandidata dobitnika stipedije, smatrace se da je odustao sa stipendije i dobitnik bice kandidat koji je na redu u tom spisku.

**14.3.** Rok za dodelu stipendije , obaveze dobitnika stipendije i ostali uslovi, odredice se sa ugovorom.

## V. PROCEDURE PLACANJA

**Clan 15.**

**15.1**. Finansijska sredstva bice dodeljena na 1 (jednu) ili 2 (dva) odredjena perioda fiskalne godine na bankarskom ziro-racunu dobitnika, pri banci kojeg bira student.

**15.2**. Uprava za Privredu, Finansije i Razvoj kao i Uprava za Obrazovanje, obavezujuci su da se staraju o dodeljivanju gore navedenih sredstava na odredjenom roku.

## VI. ZAVRSNE ODREDBE

**Clan 16.**

Ovaj pravilnik moze se promeniti sa istom procedurom sa ovim usvojenim.

**Clan 17.**

Ovaj pravilnik stupa na snagu po usvajanju od strane Skupstine Opstine Vitina.

**Predsedavajuci Skupstine,**

**Naim Pira**

**01.br.013/246**
**Vitina, 02.03.2015.godine.**

REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA · KOMUNA E VITISE · OPSTINA VITINA · KUVENDI · KOMUNES · SKUPSTINA OPSTINE · 1